

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. \_\_\_\_\_  
Nr. I faq. \_\_\_\_\_  
Broj stranica 3  
Nr. pages \_\_\_\_\_

Nr. Prot. \_\_\_\_\_  
Br. Prot. \_\_\_\_\_  
Prot No. 01/1734/10  
Data \_\_\_\_\_  
Datum 08.04.2010  
Date \_\_\_\_\_

PRISHTINE



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KRPP - RKJN - PPRC

Nr. 34/2010  
Dt. 08.04.2010



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK  
REGULATORNA KOMISIJA JAVNE NABAVKE  
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION

## MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT

### NË MES TË

### AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KOMISIONIN RREGULLATIV TË PROKURIMIT PUBLIK

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit pajtohen si në vijim

#### I

Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik krijojnë raporte të partneritetit dhe bashkëpunimit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit përmes:

1. Dhënies së informatave lidhur me korrupsionin;
2. Bashkëpunimin në hetimin e rasteve që rezultojnë me veprime kriminale të korrupsionit që kanë të bëjnë me prokurimin publik;
3. Ndhmën dhe asistencën teknike të ndërsjellë në proceset hetimore;

#### II

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik do t'i ofrojë ndihmë Agjencisë Kundër Korrupsionit në proceset e iniciuara hetimore nga sfera e natyrës së korrupsionit që ka të bëjë me prokurimin publik përmes dhënies së informatave, ndihmës teknike dhe formave të tjera konform legjislacionit në fuqi.

#### III

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik më kërkesë të Agjencisë kundër Korrupsionit obligohet që ti dorëzojë dokumentacionin e kërkuar nga kjo Agjenci në pajtueshmëri më Ligjin për Agjencinë kundër Korrupsionit nr. 03/L-159.

#### IV

Agjencia Kundër Korrupsionit do t'i ofrojë ndihmë Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik në procedimin e rasteve të natyrës kundër-korrupsion nga sfera e kompetencës së përbashkët që dalin nga Ligji për Agjencinë kundër Korrupsionit nr. 03/L-159 dhe Ligji për Prokurim Publik nr. 02/L-99 për ndryshimin e Ligjit për Prokurim Publik 2003/17.

#### V

Agjencia kundër Korrupsionit do të njoftojë Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik në rastet kur gjen shkelje të procedurave të prokurimit nga Autoritetet Kontraktuese dhe Operatorët Ekonomik sidomos në rastet kur gjen se Operatorët Ekonomik kanë bërë falsifikim të dokumenteve për fitim të tenderëve.

#### VI

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje pajtohen që të zgjerojnë fushën e bashkëpunimit në luftimin e korrupsionit edhe përmes formave të tjera si:

1. Trajnime të përbashkëta;
2. Pjesëmarrja në Seminare të përbashkëta;
3. Shkëmbim të ndërsjellë të informatave;

#### VII

Palët nënshkruese pajtohen të bashkëpunojnë plotësisht në realizimin e pikave që dalin nga neni 5 i Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit nr. 03/L-159, nga secila palë nënshkruese e kësaj marrëveshje konform akteve ligjore të cekura më lart.

#### VIII

Parimet e ruajtjes së konfidencialitetit të informatave dhe dokumenteve të kësaj natyre, do të zbatohet me përpikëri në mes të palëve nënshkruese. Ky obligim shtrihet në parandalimin e pengimit të çfarëdo forme të veprimit që mund të shkaktojë konflikt të kompetencave në mes të palëve nënshkruese.

#### IX

Bashkëpunimi do të realizohet në mes të zyrtarëve përkatës kontaktues si dhe në pajtueshmëri të plotë me zotimet që dalin nga kjo Marrëveshje.

#### X

Në rast të paraqitjes së konfliktit të kompetencës, rastet e paraqitura do të raportohen te Menaxhmenti i institucioneve palë të kësaj Marrëveshje, të cilët japin mendimin përfundimtar për çështjen e ngritur.

## XI

Për çdo ndryshim në legjislacionet e cekura më lartë dhe në ligjet tjera të kësaj lëmie, palët do të rinegociojnë mundësinë e përfshirjes së ndryshimeve, në afat prej 30 ditësh në këtë Marrëveshje.

## XII

Asnjë nga veprimet e cekura më lart, që adresojnë format e bashkëpunimit ndërinstitucional nuk guxojnë të përdoren për dëmtimin e proceseve hetimore apo formave tjera të publikimeve që mund ta diskreditojnë secilën palë nënshkruese të kësaj Marrëveshje.

## XIII

Kjo Marrëveshje shfuqizohet:

- a. Me paralajmërim nga njëra palë në afat prej 30 ditësh
- b. Automatikisht nëse shkelen dispozitat e Marrëveshjes.

## XIV

Rishikimi i bashkëpunimit dhe raportimi i të arriturave do të bëhet në çdo fund-viti kalendarik përmes takimit të rregullt që do të mbahet në mes të zyrtarëve kontaktues dhe menaxhmentit përkatës të institucioneve nënshkruese të kësaj marrëveshje.

## XV

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të tij nga Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Marrëveshja u dorëzohet në origjinal:

- 1 x Agjencisë kundër Korrupsionit
- 1 x Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;

